

VENDIM
Nr.56, datë 19.1.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS DHE TË RREGULLAVE PËR PAGIMIN E SAJ NË NJË
PROCEDURË ANKIMI NDAJ PROCEDURAVE TË ANKANDIT PUBLIK APO VENDIMEVE PËR
PËRJASHTIM NGA TO, PRANË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, pika 9, të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ankesa e paraqitur në rrugë elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KKP), nga çdo person që ka ose ka pasur një interes të ligjshëm në një procedurë ankandi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, duhet të përmbajë dokumentin bankar që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse.

2. Përgjashtimisht, kur legjislacioni në fuqi parashikon një mjet tjetër komunikimi, ankesa e paraqitur pranë Komisionit shoqërohet me dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse, në numrin e llogarisë së KPP-së.

3. Tarifa për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja është 0.5% e vlerës fillestare të ankandit publik që ankimohet.

4. Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës, ndërsa moskryerja e saj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga KKP-ja.

5. PAGESA e tarifës i kthehet ankimesit kur, në fund të procesit të ankimit, ankesa e tij pranohet.

6. Kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimit derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha